

VENDIM
Nr. 763, datë 12.12.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË
PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT NË NJËSITË
TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE**

(ndryshuar me vendimin nr. 134, datë 8.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 5/1, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit e njësive teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtimisht, deri në datën 1 janar 2023, masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për nëpunësit e përcaktuar në rreshtat 4 dhe 6, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të jetë përkatësisht, 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj dhe 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 nëntor 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

**MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E
PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT E NJËSIVE TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE**

(ndryshuar me vendimin nr. 134, datë 8.3.2023)

NR. RENDOR	POZICIONI	MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
1	Titullar i institucionit	800 000
2	Zëvendësdrejtore i përgjithshëm dhe drejtore drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e konformitetit të certifikimeve, qeverisjes së sigurisë kibernetike, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, zhvillimit strategjik, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, monitorimit dhe reagimit të incidenteve.	280 000
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të	220 000

	transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	
4	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	150 000
5	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	190 000
6	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbytjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	120 000